

Vështrim_{mbi} #Filantropinë

BULETIN 3MUJOR Nr.6, Shtator 2019

Çmimi i Filantropisë 2019



Partnerët Shqipëri, gjatë muajve gusht – shtator, shpalli thirrjen për nominime për konkursin Çmimi i Filantropisë 2019. Si çdo vit, publiku i gjerë u ftua të nominojë për kategoritë:

- Çmimi për Kompani me Kontribut në **Nivel Kombëtar**
- Çmimi për Kompani me Kontribut në **Nivel Lokal**
- Çmimi për Kontributin si **Individ**

Për të pestin vit radhazi Partnerët Shqipëri po kryen monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale, si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike. Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve. Nëpërmjet këtij buletini Partnerët Shqipëri prezanton të dhëna infografike mbi monitorimin e këtij aktiviteti, si dhe rastet e mbështetjes dhe dhurimit, në Shqipëri dhe rajon.

FAQE 1

Shpallet Konkursi "Çmimi i Filantropisë 2019"

FAQE 2-5

Fakte mbi Aktivitetin Filantropik në Shqipëri Gusht - Shtator 2019

FAQE 6-7

Telekom Albania mbështet ZA Fest

FAQE 8

Përurohet Qendra PRO PAK
Digitalb mbështet krijimin e kopshtit për fëmijë

FAQE 9


Made in Prison faqja e internetit që reklamon produkte artizanale nga gratë e burgosura në Tiranë

FAQE 10


The Global Landscape of Philanthropy – raporti pasqyron një panoramë gjithëpërfshirëse të trendeve dhe sfidave aktuale mbi filantropinë në të gjithë botën



Fakte mbi Aktivitetin Filantropik
Korrik—Shtator 2019



Përfituesit përfundimtar



Fëmijët dhe Të rinjtë pa përkujdesje prindërore janë përfituesit kryesor, duke mbuluar 22% të numrit të përfituesve final. Jo vetëm që shoqëria është veçanërisht e ndjeshme ndaj këtij grupi por ka disa donatorë të rregullt, të cilët dhurojnë në mënyrë të vazhdueshme tek institucionet publike që ofrojnë përkujdesje ndaj këtyre fëmijëve si: Balfin Group, Farma Vitta, Fondacioni "Shpresë për Botën", etj.






Rreth 44% e dhurimeve kanë shkuar në Mbështetje të Grupeve të Margjinalizuara. Disa shembuj janë kompanitë si Alpha Bank dhe Union Bank, të cilët ishin disa nga dhuruesit që bënë të mundur hapjen e qendrës Pro Pak. Kjo qendër do të ofroj shërbime të ndryshme për fëmijë dhe të rritur më paafësi intelektuale. Një tjetër rast është Credins Bank që ofroj disa pajisje të reja për Shtëpinë e të Moshuarve në Kavajë.

Qëllimi i dhurimit




Vlera e dhurimeve sipas natyrës





Donatorët kryesor për këtë periudh janë **Korporatat** dhe dy fushat kryesore të mbështetjes janë Mbështetje për Grupet e Margjinalizuara dhe Art&Kulturë. Këto fusha edhe pse të ndryshme nga njëra tjetra janë megjithatë plotësuere pasi shërbejnë për të sjell pak lumturi tek njerzit dhe ndihmojnë personat vulnerabël duke i ofruar atyre mbështetje në forma të ndryshme si materiale apo edhe trajtime mjeksore. Disa shëmbuj që mund të përmendim janë: Këndi i lojrave nr.45, mbështetja e ofruar nga korporata të ndryshme për Down Syndrome Albania dhe eventet e ndryshme kulturore si: 2B Jazz!, “Maratona e Këngës 2019, “Muzika Internacionale në Korçë”, etj.



Në 45% të rasteve lloji më i preferuar i dhurimit ka qënë **dhurimi direkt**. Arsyeja mund të jetë fakti që nuk ka nevojë për ndërmjetës dhe dhuruesit e kryejnë vetë dhurimin për kauzën që atyre i duket më e drejtë. Disa shëmbuj të rëndësishëm janë dhurimet e Raiffeisen Invest, që dhuruan për Universitetin “Eqerem Çabej” në Gjirokastër, duke iu mundësuar një laborator të ri TIK, apo DigitAlb që inaguroj një lulishte të re në Korrik.



- F&R**—Fëmijë dhe të rinjtë
- Dhurime Sezonalë** – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave
- Mix**—Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet.
- OJF**—Organizata Jofitimprurëse
- Publik i Gjerë**—Një grup i vogël apo i madh njerëzish
- G&F**— Gra dhe Fëmijë

- Ndihmë Ekonomike**—Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë me vështirësi ekonomike apo gjatë fatkeqësive natyrore.
- NVM**—Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
- Zonë Specifike**—Zonë Gjeografike Specifike

Telekom Albania *mbështet* ZÂ Fest



Telekom Albania ishte një prej mbështetësve të edicionit të tretë të ZÂ Fest, nëpërmjet paketës Electronic Beats.

Festivali, i cili nisi me idenë thjesht për mbrojtjen dhe konservimin e mjedisit në zonën e Thethit, këtë vit solli bashkë artistët si Vlashent Sata, Elina Duni, artistin anglezo-italian Piers Faccini, animatorin Bob Berky dhe aktorin e njohur shqiptar Arben Bajraktari, të cilët performuan falas për publikun.

Qëllimi i këtij festivali ishte ribashkimi i njerëzve përmes artit, duke ofruar aktivitete si kinema verore, recitim të gojëdhënave, tregimeve, legendave dhe përallave të moçme.

#madeinprison

Made in Prison është faqja e internetit ku reklamohen produktet artizanale të punuara nga gratë e burgosurat në burgun numër 325 në Tiranë.

Ky projekt është një iniciativë e Shoqatës Shqiptare Orkidea, një OJF lokale që punon për përmirësimin e të drejtave të grave dhe të rinjve në Shqipëri, dhe fuqizimin social - ekonomik të tyre.

Të gjitha fitimet nga shitjet e produkteve shkojnë në llogaritë personale bankare të krijueses përkatëse të secilit produkt.

Shoqata Orkidea aktualisht paguan për materialet e produkteve, por pjesëmarrësit kanë shprehur dëshirën për të mbuluar disa prej këtyre kostove në të ardhmen, si një mënyrë për ta kthyer iniciativën në një model të qëndrueshëm biznesi.

Duke marrë frymëzim nga modelet më të fundit dhe nën drejtimin e një dizajneri profesional, janë krijuar një gamë produktesh. Made in Prison shpreson t'u sigurojë një sërë aftësish profesionale që mund t'i ndihmojë këto gra të kenë sukses dhe përfshirje në botën e jashtme.



Burimi: exit.al | emerging-europe.com | madeinprison.al

Përurohet Qendra PRO PAK



Fondacioni "Down Syndrome Albania" përuroi qendrën më të re për ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi ndryshe, Qendra PRO PAK. Disa nga donatorët që kontribuan në hapjen e kësaj qendre ishin edhe Alpha Bank dhe Union Bank.

Qendra do të ofrojë shërbim për 100 fëmijë dhe të rritur me aftësi ndryshe. PRO PAK do të ofrojë shërbime të ndryshme si terapi individuale dhe në grup, terapi fizike, terapi arti dhe muzike apo kurse shkrimi dhe leximi.

Burimi: dsalbania.org | [facebook.com](https://www.facebook.com)

DigitAlb dhuratë Një kënd lojrash për fëmijë



Në kuadër të 15 vjetorit, kompania mediatike DigitAlb në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhuruan një kënd lojrash dhe hapësira të reja për fëmijët dhe banorët e lagjes nr. 9. Parku u përuroi gjatë muajit korrik, ku ishte prezent kryetari i bashkisë Tiranë, Z. Erjon Veliaj dhe përfaqësuesja e DigitAlb, Erjona Kokona.

Znj. Kokona shprehu se është mjaft e rëndësishme që të mundësohen sa më shumë mënyra argëtimi për fëmijët dhe se banorët tashmë përveç këndit të lojrave për të vegjëlit e tyre kanë gjelberim, stola, dhe infrastrukturë ndihmuese.

Burimi: gazetakombi.com | digital.al | tiranapost.al

The Global Landscape of Philanthropy



Linku i raportit : <https://wings.issuelab.org/resources/29534/29534.pdf>

The Global Landscape of Philanthropy

Ky raport paraqet një panoramë gjithëpërfshirëse të trendeve dhe sfidave aktuale në të gjithë botën, përfshirë këtu edhe format e ndryshme të dhurimeve. Duke filluar nga dhurimet individuale deri tek dhurimet nga komuniteti, dhurimet e strukturuar dhe ato institucionale.

Gjithashtu ngre disa pyetje dhe çështje kritike dhe thelbësore për zhvillimin e filantropisë - si ndikimi i teknologjisë së re dhe turrja e hapësirës qytetare në dinamikën e pushtetit brenda praktikës dhe koncepteve të filantropisë, gjithashtu flet mbi rolin dhe formën evolucionare të infrastrukturës filantropike. Së fundmi por jo nga rëndësia, raporti tregon se modelet që dominojnë në Amerikën e Veriut dhe Evropë - shpesh të përdorura si një pikë referimi, për t'u kundërshtuar, personalizuar ose asimiluar nga të tjerët - në fakt janë vetëm një pjesë e panoramës më të gjerë.

GJETJET KRYESORE:

- Dhurimet individuale janë më të mëdha sesa dhurimet institucionale për sa i përket shumës së dhuruar pothuajse kudo në botë, megjithëse pjesa më e madhe është e padukshme.
- Metodrat e reja të dhurimit të prezantuar nga avancimi teknologjik – dhurimi nëpërmjet internetit, dhurimit përmes SMS dhe dhurimet përmes platformave crowdfunding - kanë një rëndësi të madhe, por ato janë akoma të kufizuara në shumicën e vendeve.
- Në përgjithësi numri i fondacioneve është në rritje, veçanërisht në Evropë dhe në disa vende të jugut global. Dy arsye kryesore për këtë janë rritja e të ardhurave dhe inkurajimi nga qeveritë për zhvillimin e filantropisë për të ndihmuar në plotësimin e buxheteve të tyre. Në të njëjtën kohë, ekziston një prirje që të pasurit të dhurojnë pa patur nevojë për të ngritur një fondacion.
- Fondacionet me baza komunitare janë të përhapura pothuajse kudo dhe ato luajnë një larmi rolesh, duke filluar që nga krijimi i një komuniteti deri tek ofrimi i shërbimeve të donatorëve, por gjithashtu edhe filantropia me baza komunitare është përhapur gjerësisht dhe po ndodh në mënyrë informale.
- Fondacionet gjithnjë e më shumë po eksplorojnë mënyra të reja për përdorimin e aseteve të tyre, si në formën e filantropisë së korporatave, investimeve me impakt social dhe investimeve në formën e përgjegjshmërisë sociale, dhe / ose duke përdorur asetet siç janë ekspertiza, reputacioni dhe fuqia mbledhëse.
- Megjithëse qeveritë janë të prirura të inkurajojnë shoqërinë civile dhe filantropinë kur OSHC-të bëjnë punën që ata miratojnë, ata gjithnjë e më shumë po ndërmarrin hapa për të zvogëluar aktivitetet e OSHC-ve në fusha sensitive politike, qoftë nëpërmjet një kufizimi zyrtar ose nëpërmjet një ngacmimi joformal.



Rruga e Elbasanit, Pallati Park Gate, Kati 10, Ap. 71/73, Kutia Postare 2418/1, Tiranë, Shqipëri.

Tel. Faks: 04 2254881

Email: partners@partnersalbania.org

<http://www.partnersalbania.org>